MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KRUJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Krujë me objekt: "Zbatimin e detyrave të lëna më parë, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 138, datë 28.9.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 573/10 , datë 15.9.2012 , dërguar **z. Shkëlzen HOXHA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa nga Zyra e Urbanistikës e cila në bashkëpunim me INU-në dhe Policinë Bashkiake të evidentojë në terren gjendjen e objekteve për të cilat është miratuar leja e ndërtimit por nuk është zbardhur. Të merren masa bllokimi dhe në bazë e zbatim të ligjit të përmbushet detyra ligjore, për zbatimin e detyrimeve që kanë subjektet ndaj bashkisë, për shkak të mos plotësimit të të cilave është mbajtur pezull zbardhja e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë

2. Të ngrihet një grup pune, për verifikimin e mangësive që kanë dosjet e lejeve të shesheve dhe lejeve të ndërtimit, i cili të angazhohet në plotësimin e tyre me dokumentacionin e kërkuar; përcaktimin e kondicioneve urbanistike; studimin e gjendjes ekzistuese në funksion të procesit të hartimit të planit të përgjithshëm rregullues si dhe të arkivohen dosjet sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Menjëherë

3. Të merren masa, për regjistrimin e lejeve të ndërtimit pas zbardhjes; ndjekjen e tyre deri në dhënien e lejes së shfrytëzimit. Të evidentohet qartë dhe saktë detyrimi për financimin e studimeve urbanistike; ndikimi në infrastrukturë. Të kontabilizohen më vete dhe të respektohet destinacioni i përdorimit të tyre sipas ligjit.

Vazhdimisht

4. Të merren masa, për administrimin e dosjeve teknike të ndërtimit të objekteve dhe arkivimin e tyre pasi të kryhet plotësimi i detyrimeve nga subjektet në përputhje e sipas projekteve të zbatimit të volumeve të punimeve në sasi dhe cilësi.

Menjëherë

5. Të merren masa, për të gjitha kërkesat për sheshe e leje ndërtimi, të cilat nuk duhet të shqyrtohen dhe miratohen pa miratuar më parë nga KRRTRSH studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor si dhe studimi urbanistik pjesor, i cili hartohet në zbërthim e zbatim të studimeve urbanistike rajonale apo planeve rregulluese.

Vazhdimisht

6. Të merren masa, që të mos miratohen leje shfrytëzimi pa dokumentacionin e plotë tekniko, ligjor, duke rritur përgjegjshmërinë e personave përgjegjës dhe evidentuar mangësitë, si dhe duke kërkuar eliminimin e tyre përmes zbatimit të sanksioneve ligjore, në rast se ato shkelen.

Vazhdimisht

7. Të merren masa, e të tregohet përgjegjshmëri në vijim ndaj, të gjitha kërkesave për leje sheshi e leje ndërtimi, të cilat nuk duhen të shqyrtohen dhe miratohen pa pasur më parë

Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis; Raportin me të dhënat gjeologjike inxhinierike të sheshit dhe Projektin e plotë të ngrohjes si dhe të gjitha dokumentacionin tekniko ligjore.

Vazhdimisht

8. Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për 2 inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik pa arsim, të cilët duhet të zëvendësohen me inspektorë me arsimin e duhur profesional, ashtu siç përcaktojnë kërkesat e ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 11 "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik".

Menjëherë

9. Nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), dhe Zyra e Urbanistikës, të evidentohen ndërtimet pa leje, e të aplikohen gjoba ndaj subjekteve ndërtuese në kundërshtim me ligjin, me qëllim mbajtjen nën kontroll administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Vazhdimisht

10. Nga inspektorati ndërtimor urbanistik vendor, të merren masa në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" me ndryshime, në zbatim të nenit 5 pika "d" e "dh", të nisin menjëherë veprimet për prishjen e ndërtimeve të paligjshme me destinacion furra gëlqere që operojnë në territorin administrativ të Bashkisë Krujë

Brenda vitit 2012

11. Të hartohet program i posaçëm pune për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat, kryesisht nga subjektet me aktivitet "Inerte". Të ardhurave nga taksat dhe tarifat nga popullata, pasi rezultojnë 141 subjekte debitorë në vlerën **4,677,000 lekë** nga të cilët:

-57 subjekte kanë likuiduar detyrimet pjesërisht dhe 84 subjekte janë pa likuiduar, nga këta 19 subjekte janë biznes i madh dhe 65 subjekte biznes i vogël. Nga subjektet biznes i madh 10 prej tyre nuk kanë shlyer për 2 vjet radhazi në vlerën **1,960,420 lekë.**

Menjëherë

12. Të ngrihet grup pune dhe të bëhet evidentimi i plotë i të gjitha familjeve, pasi rezulton të ketë në paketën përkatëse fiskale rezerva në planifikimin e taksave të ndërtesave, tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit, natyrisht duke bërë argumentimin përkatës për zvogëlim të numrit të familjeve vetëm me vendim të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë

13. Nga Zyra e Taksave të hartohet paketa me llojet dhe masat e gjobave, duke i propozuar Këshillit Bashkiak, të vendosë masën e gjobës për llojet e çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 6 "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative" dhe punonjësit e Policisë së Bashkisë të ekzekutojnë vendimet për aktbllokime sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë.

Për subjektet e mësipërme t'i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, vendosja e barrës në pasuritë e paluajtshme.

Brenda muajit Tetor 2012

14. Të merren masa, për nxjerrjen e rezultateve të biletave të marra nga personat me kontratë pune provizore për parkimin e automjeteve dhe tregut të lirë të perimeve, me qëllim kontrollin e aktivitetit të lirë (sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 02, datë 27.01.2003).

Menjëherë

15. Të bëhen përpjekje për rekrutimin e punonjësve (specialistë) me arsim të lartë, sipas kërkesave të vendit të punës dhe të merren me konkurrim konformë kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për Statusin e Nëpunësit Civil".

Për 3 punonjësit agjent të taksave të tregut, të pezullohet kontrata e punës deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë

16. Të kërkohet nga i ngarkuari me administrimin e burimeve njerëzore për plotësimin e dosjeve nga 2 punonjësit (një punonjës i sektorit të taksave dhe një punonjës i zyrës së

urbanistikës) me dokumentin origjinal të diplomimit nga Universiteti ku kanë përfunduar studimet në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" si dhe të Aneksit I dhe II të VKM nr. 355, datë 7.7.2000 "Për organizimin e dosjes dhe regjistrit personelit", si dhe të kryhet pagesa sipas diplomës përkatëse dhe për pagesën e deritanishme të bëhet llogaritja e të kërkohet arkëtimi nga:

a. [redacted] me detyrë inspektor në zyrën e të ardhurave,

b. [redacted] me detyrë specialist në zyrën e Urbanistikës.

Menjëherë

17. Audituesi i brendshëm të ndërtojë programe pune sipas kërkesave të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe në përputhje me problematikat, që ka institucioni t'u paraprijë fenomeneve para faktit, gjatë ecurisë së zbatimit të tyre dhe mbas faktit, kryesisht në të ardhurat nga taksat dhe tarifat, në rakordimet midis detyrimeve dhe pagesave, kontabilizimin e detyrimeve dhe shpenzimeve në çdo fazë të kryerjes së tyre.

Vazhdimisht

18. Të bëhen veprimet në kontabilitet, për vlerën prej **5,281,476 lekë**, në mbështetje të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 39 datë 21.11.2011 "Për miratimin e nxjerrjeve jashtë përdorimit të inventarëve".

Menjëherë

19. Të kërkohet miratim në Këshillin Bashkiak, për shkarkimin e vlerës **313,650 lekë** nga kontabiliteti në bilancin e vitit 2010, që i përket llogarisë nr. 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje", e cila rezultoi e shkarkuar nga kontabiliteti pa vendim të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë

20. Të analizohet e të saktësohet, teprica e llogarisë nr. 423-429 "Personeli paradhënie difiçite e gjoba", e pasqyruar në bilancin e vitit 2010, për vlerën **525,739 lekë** dhe e fshirë nga bilanci i vitit 2011 pa artikull kontabël duke u bërë edhe sistemimet përkatëse.

Menjëherë

21. Të analizohen tepricat e llogarive të aktivit të bilancit të vitit ushtrimor 2011, pasi nuk ka analizë për çdo person (xhiro debitore-kreditore), konkretisht:

-Llogaria nr. 431 "të drejta e taksa për t'u derdhur në shtet", për **5,317,680 lekë**.

-Llogaria nr. 468 "Debitorë të ndryshëm", për **756,192 lekë**.

Menjëherë

22. Të merren masa që të ndërpriten pagesat nga arka për shpenzime, që nuk kanë kaluar nëpërmjet Degës së Thesarit Krujë.

Menjëherë

23. Dokumentacionet e arkës (mandat arkëtimet e mandat pagesat), të plotësohen në mënyrë kronologjike e sistematike, të kontabilizohen në ditarët përkatës si dhe të bëhen regjistrimet në kontabilitet. Gjithashtu të plotësohen në numër rendor me rend rritës gjatë vitit ushtrimor dhe të kontabilizohen që nga muaji Janar 2012 e në vazhdim. Nga sektori i financës, specialisti përkatës të auditojë periodikisht çdo muaj dhe të kryejë rakordime periodike me sektorët që krijojnë të ardhura.

Vazhdimisht

24. Në programimin e buxheteve të viteve të ardhshme, të programohen shpenzimet duke përfshirë detyrimet e konstatuara të vitit ushtrimor të mbyllur, të analizohen shkaqet e krijimit.

Vazhdimisht

25. Të rakordohet me ZVRPP Krujë, për pasurit e paluajtshme të kaluara në administrim të Bashkisë Krujë, sipas vendimeve përkatëse të nxjerra nga Këshilli i Ministrave për Bashkinë Krujë.

Vazhdimisht

26. Të rakordohet me Zyrën Arsimore Krujë, për furnizimet me mallra e materiale në adresë të shkollave në juridiksion të bashkisë, duke i bërë ato hyrje në magazinën e bashkisë (në momentin e tërheqjes mallit).

Vazhdimisht

27. Nga ana e bashkisë, të vihet në dijeni Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për inventarin e Shkollës Profesionale Krujë (pajisje të reja inventari për konviktin), të bëra hyrje me fletë hyrjen nr. 25, datë 19.04.2010, me vlerë **6,300 mijë lekë**, dhe për mundësinë e përdorimit në një shkollë tjetër apo subjekte të tjera.

Menjëherë

28. Për rekrutimet në punë të punonjësve të policisë bashkiake, përpara emërimit të këtyre punonjësve të ngrihen komisione të posaçme, në përbërje të këtyre komisioneve të jenë edhe të deleguar nga Prefektura e Qarkut Durrës si dhe përfaqësues nga Komisariati i Policisë Durrës.

Vazhdimisht

29. Zyra e Financës të mbajë regjistra të saktë e me përgjegjësi për sa i përket blerjeve e shërbimeve me vlera të vogla, konform legjislacionit në fuqi, me qëllim kontrollin e mos kalimit të kufirit prej 480 mijë lekë së bashku me t.v.sh-në.

Vazhdimisht

30. Të merren masa për kontabilizimin e godinës "Shkolla 9-vjeçare nr. 1, Krujë" me vlerën 57,024,000 lekë.

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, përmes respektimit të të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit me vlerën **3,246,273 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

a) Nga mos zbatimi i detyrave të mëparshme të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 284/5, datë 22.09.2010, germa "B"-masa për shpërblim dëmi në vlerën prej **2,545,661 lekë,** nga sipërmarrësit e objekteve të ndërtimit për vitet 2008-2009, për pagesa të pa argumentuar me dokumentet përkatëse, për dy sipërmarrësit.

a.i) [redacted] me vlerë **868,000 lekë**, për diferenca në zëra dhe volume punimesh në objektin "Sistemim i sheshit para Bashkisë Krujë";

a.ii) [redacted]. me vlerë **1,677,661 lekë**, për diferenca në zëra dhe volume punimesh në objektet:

-"Sistemim i rrugës së Shkollës 9-vjeçare Abaze Krujë" për **343,656 lekë**;
-"Ndërtim i konviktit Shkolla e Mesme e Qytetit Krujë" për **490,614 lekë**;
-"Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare Nabaze Krujë" për **843,391 lekë**.

b) Sipërmarrësi me bashkim operatorësh ekonomik [redacted] përfaqësuar nga administratori i shoqërisë [redacted], për vlerën **582,200 lekë** në objektin "Rehabilitim shkolle 9-vjeçare nr. 1, Krujë", të kryer sipas kontratës për punë publike nr. 118, datë 8.02.2011, për pagesa të pa argumentuar në dy zëra punimesh veshje me pllaka majolike në vlerën 470,000 lekë dhe lyrje me hidromat në vlerën 112,200 lekë.

c) detyrimin në vlerën **112,500 lekë** të përfituar padrejtësisht nga 2 punonjës, veprim që bie ndesh me pikën 5, kreu III, neni 11 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", VKM nr. 693, datë 18.08.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe konkretisht:

c.i) [redacted] me detyrë inspektor në Zyrën e të Ardhurave në bashki vlera **97,500 lekë**, (për vitin 2010 shumën **71,500 lekë**, dhe periudha dhjetor 2010 deri 31 dhjetor 2011 vlerën lekë **26,000 lekë);**

c.ii) [redacted] me detyrë specialist në Zyrën e Urbanistikës, përfituar më tepër vlerën **15,000 lekë** për vitin 2011.

Brenda datës 30.12.2012

d) mungesën e gjendjes fizike të arkës, nga kryerjet e veprimeve të gabuara ndërmjet arkëtimeve e derdhjeve përkatëse në bankë, nga arkëtarja [redacted]. vlerën prej **5,912 lekë.**

Menjëherë

C. <u>MASA ADMINISTRATIVE</u>

I. Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 15, ndryshuar me nenin 2 te ligjit nr. 9826 datë 01.11.2007, për shkelje të neni 7, pikës 1, 3, 4 paragrafi ¾. 17, 18, 19, pikës 3, 3/a,b,c, 7/e të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve", pikës 8, 8/1, 8/2, 10, të kreut 2, pikat 4, 5 të kreut III të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i propozoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Ndërtimit dhe Urbanistikës pranë Bashkisë Krujë të vendosë gjoba për punonjësit e mëposhtëm:

1. [redacted], **gjobë në masën 50.000 lekë,** në cilësinë e Mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Rehabilitim shkolle 9-vjeçare nr. 1, Krujë", me kontratën e shërbimit nr. 152, datë 17.02.2011, për vlerën **705,000 lekë**.

Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruar në dosjen teknike, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitime më tepër nga sipërmarrësi në vlerë **582,200 lekë,** për dy zëra pune:

a-Zëri B/IV/4, Veshje me pllaka majolike;

b- Zëri B/IV/8, Bojatisje me hidromat brenda.

2. [redacted] **gjobë në masën 50.000 lekë,** në cilësinë e Kolaudatorit në objektin "Rehabilitim shkolle 9-vjeçare nr. 1, Krujë" me kontratën e shërbimit nr. 1061, datë 9.01.2012, me vlerë **177,331 lekë**.

Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruar në dosjen teknike, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitime më tepër nga sipërmarrësi në vlerë **582,200 lekë,** për dy zëra pune:

a-Zëri B/IV/4, Veshje me pllaka majolike;

b- Zëri B/IV/8, Bojatisje me hidromat brenda.

II. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar i propozoj Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të vendosi gjobë si rezultat i mosushtrimit të funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës në masën **200,000 lekë** ndaj:

1. [redacted] me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik i komanduar, nga periudha 31.01.2010 deri më datë 01.11.2010, pasi:

-në 8 vendime pezullimi punimesh, të cilat janë ndërtime pa leje, nuk janë ndëshkuar me gjobë si përcaktohet në nenin 81 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet, gjithashtu nuk ka ndonjë rakordim me Zyrën e Urbanistikës;

-vendimet e prishjes për 4 objekte, nuk janë shoqëruar me vendime ekzekutimi;

-në Bashkinë Krujë nga të dhënat e Sektorit të Urbanistikës, Drejtorisë së Tatim Taksave në segmentin rrugor Krastë - Krujë operojnë 24 subjekte prodhuese dhe tregtuese, konkretisht sipas llojit të aktivitetit:

-Prodhim Gëlqere 10 subjekte; - Gurore 9 subjekte; -Inerte 5 subjekte.

INU e Bashkisë Krujë nuk ka ushtruar kontrolle sipas përcaktimeve në nenin 12 të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 me ndryshime, ku përcaktohet se: "*INU-së i lind e drejta për ushtrimin e kontrolleve në mjediset (kantjere ndërtimi) ku kryen ndërtime dhe ku prodhohen materiale ndërtimi"*, si dhe kërkesat e parashikuara në neni 80 të ligjit nr 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet.
-nga veprimtaria e këtyre subjekteve, në këtë zonë po ndodh vazhdimisht ndotje masive me pasojë në mjedis dhe në jetën e komunitetit si dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore;
-për sa më sipër lidhur me furrat e gëlqeres të cilat nuk janë të pajisura me leje ndërtimi, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë nuk ka përmbushur detyrën ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës pasi për këto raste nuk ka vendosur gjoba, nuk ka vendosur pezullim të punimeve, nuk ka vendosur prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, nuk ka përgatitur kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit lidhur me ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit dhe ta paraqiste atë pranë organeve përgjegjëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 4, përgjegjësitë e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 5, detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 12 pargrafi i parë, ushtrimi i kontrollit;
-nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik për 21 lejet e ndërtimit, 10 prej subjekteve ndërtues nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve si përcaktohet në nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe nga ana e INU-së nuk janë ndëshkuar me gjobë, siç përcaktohet në nenin 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 me ndryshimet;
-nga ana e Inspektoratit Ndërtimor nuk na u paraqit ndonjë informacion apo relacion mbi gjendjen e situatës ndërtimore në Bashkinë Krujë.
2. [redacted] me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, nga periudha 01.11.2010 deri 31.12.2011, pasi:
-në 8 vendime pezullimi punimesh, të cilat janë ndërtime pa leje, nuk janë ndëshkuar me gjobë si përcaktohet në nenin 81 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet, gjithashtu nuk ka ndonjë rakordim me Zyrën e Urbanistikës;
-vendimet e prishjes për 2 objekte, nuk janë shoqëruar me vendime ekzekutimi;
-në Bashkinë Krujë nga të dhënat e Sektorit të Urbanistikës, Drejtorisë së Tatim Taksave në segmentin rrugor Krastë - Krujë operojnë 24 subjekte prodhuese dhe tregtuese, konkretisht sipas llojit të aktivitetit:
-Prodhim Gëlqere 10 subjekte; -Gurore 9 subjekte; -Inerte 5 subjekte.
INU e Bashkisë Krujë nuk ka ushtruar kontrolle sipas përcaktimeve në nenin 12 të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 me ndryshime, ku përcaktohet se: "*INU-së i lind e drejta për ushtrimin e kontrolleve në mjediset (kantjere ndërtimi) ku kryen ndërtime dhe ku prodhohen materiale ndërtimi"*, si dhe kërkesat e parashikuara në neni 80 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet.
-Përgjegjësi i INU-së [redacted] në ballafaqim deklaronte se furrat e gëlqeres nuk quheshin ndërtime dhe si të tilla nuk mund të kontrollohen që kanë apo nuk kanë leje ndërtimi, por ligji nr 8405, datë 17.9.1998 me ndryshime, në nenin 48 paragrafi i parë përcakton: "*Leja e ndërtimit kërkohet për kryerjen e punimeve si vijon*:
-Ndërtime të reja të çdo lloji, mbi e nëntokësore, shtesa impiante të ndryshme, rrugë, karriera të materialeve të ndërtimit etj".
-Nga veprimtaria e këtyre subjekteve, në këtë zonë po ndodh vazhdimisht ndotje masive me pasojë në mjedis dhe në jetën e komunitetit si dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore.
-Për sa më sipër lidhur me furrat e gëlqeres të cilat nuk janë të pajisura me leje ndërtimi, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë nuk ka përmbushur detyrën ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës pasi për këto raste nuk ka vendosur gjoba, nuk ka vendosur pezullim të punimeve, nuk ka vendosur prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, nuk ka përgatitur kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit lidhur

me ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit dhe ta paraqiste atë pranë organeve përgjegjëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 4, përgjegjësitë e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës, neni 5, detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 12 pargrafi i parë, ushtrimi i kontrollit.
-Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik për 21 lejet e ndërtimit, 10 prej subjekteve ndërtues nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve si përcaktohet në nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe nga ana e INU-së nuk janë ndëshkuar me gjobë, siç përcaktohet në nenin 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 me ndryshimet.
-Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor nuk u paraqit ndonjë informacion apo relacion mbi gjendjen e situatës ndërtimore në Bashkinë Krujë.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 dhe 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe kontratave individuale të punës, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Krujë të fillojë procedurat për dhënien e këtyre masave disiplinore, si më poshtë:

***1."Zgjidhje e kontratës së punës", për*:**

a. [redacted] me detyrë Auditues, emëruar në këtë detyrë më datë 8.4.2009 mbasi:
-nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në programin e vitit 2011, ku ishin parashikuar të kryheshin 13 auditime, në fakt është kryer vetëm një aktverifikim. Madje është hartuar për gjithë periudhën e vitit 2001 vetëm një aktverifikim, i cili nuk është nënshkruar nga personi përgjegjës, rezultati i nxjerrë nga audituesi nuk është i saktë, mbasi nuk është bazuar në furnizimin me bileta nga taksambledhësi, e cila periudhë fillon nga viti 2003;
-audituesi nuk ka ndërtuar programe pune sipas kërkesave të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" në përputhje me problematikat, që ka institucioni, në mënyrë që tu paraprijë fenomeneve para faktit, gjatë ecurisë së zbatimit të tyre dhe mbas faktit kryesisht në të ardhurat nga taksat dhe tarifat, në rakordimet midis detyrimeve dhe pagesave, pagesat e punonjësve, kontabilizimi i detyrimeve dhe shpenzimeve në çdo fazë të kryerjes së tyre;
-nuk ka kontrolluar asnjëherë gjendjen fizike të arkës së bashkisë për 2010 e 2011;
-nuk plotësohen komponentët sipas përcaktimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", duke filluar nga ato:
*të *mjedisit të kontrollit*, veçanërisht në politikat menaxheriale dhe stilin e punës të specialistëve, neni 20 i ligjit;
*të *menaxhimit të riskut* për të menaxhuar ato situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm në përmbushjen e objektivave të njësisë publike konkretisht për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat, neni 20 të ligjit;
**veprimtaritë e kontrollit* për të ushtruar kontroll gjatë aktivitetit dhe pas faktit, si është vepruar me akt bllokimet për subjektet që nuk shlyejnë detyrimet, por duhet ndjekur problemi deri në përfundim, pra arkëtimi i detyrimeve nga bizneset dhe popullata;
**monitorimi*, që ngarkon titullarët e njësisë publike të ngrenë sisteme monitorimi e menaxhimi financiar për garantimin e përditësimit të tij, përveç angazhimit të auditimit të brendshëm, që në rastin konkret nuk funksionon.

b. [redacted] me detyrë ish- Përgjegjësi i Sektorit Ekonomik deri me datën 12.9.2011 dhe aktualisht Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, pasi: aktivitetin e arkës e ka pasur jashtë kontrollit, si dhe nuk ka kryer kontrolle të gjendjes fizike të arkës, ka lejuar përdorimin e

prerjeve të mandat pagesave dhe mandat arkëtimeve jo në mënyrë kronologjike e jo në mënyrë sistematike; ka lejuar kryerjen e shpenzimeve pa kaluar më parë praktika dokumentare në Degën e Thesarit Krujë si dhe nuk ka kryer kontabilizimet përkatëse në ditarët e arkës, dhe në bilancet përkatëse, duke mos paraqitur gjendjen reale në bilanc të kryerjeve të shpenzimeve. Gjithashtu të lejimit të tejkalimit të kufirit për blerjet, shërbimet e punët e vogla të vlerës mbi 480 mijë lekë për çdo artikull.

c. [redacted]. me detyrë arkëtare pasi: ka prerë mandat arkëtime dhe mandat pagesa jo në mënyrë kronologjike e jo në mënyrë sistematike; këto dokumente origjinal nuk i ka dorëzuar në Sektorin Ekonomik (Financës) për kontabilizim, por i ka mbajtur në zyrën e saj; ka prerë mandat arkëtime për derdhjet me lekë në dorë, që kanë bërë bizneset në vartësi të bashkisë apo arkëtimet nga prindërit për fëmijët në çerdhe dhe kopshte pa ndonjë urdhër zyrtar, madje këto dokumente janë pa u firmosur nga personat përkatës sipas modelit të miratuar si dhe arkëtuar pa pasur ndonjë dokument zyrtar nga bashkia për vlerat e arkëtimeve duke vendosur vlerat pa dokument bazë; ka përdorur rreth 10% për vitin 2010 të këtyre të ardhurave për shpenzime të ndryshme pa kaluar në Degën e Thesarit Krujë, madje një pjesë e tyre janë edhe pa dokumente zyrtar apo pa firmat e përgjegjësit të sektorit ekonomik, ku e njëjta natyrë është edhe për vitin 2011 për rreth 12%; ka derdhur në Degën e Bankës Krujë në të shumtën e rasteve këto arkëtime pa prerë mandat pagesa si dhe nuk i ka derdhur të gjitha tatim takset e grumbulluar sipas aktiviteteve, por ka derdhur sipas përcaktimeve të bërë nga vetë kjo arkëtare; ka përdorur një dokument të gabuar për derdhjet në bankë të këtyre arkëtimeve, duke përdorur një format që është i përdorshëm vetëm për marrëdhëniet mes klientëve dhe bashkisë; nuk ka përdorur libër ditor arke, çka i është shmangur edhe kontrollit fizik të gjendjeve të arkës, duke përdorur një libër arke ku ka paraqitur gjendjen zero çdo muaj; ka rezultuar me mungesë arke mbas kontrollit të dokumenteve të arkës nga grupi i auditimit të KLSH-së për vlerën prej **5,912 lekë** për vitin 2010, por nuk ka raportuar për një mungesë të tillë.

d. [redacted] me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik i komanduar, nga periudha 31.01.2010 deri më datë 01.11.2010, pasi:
-në 8 vendime pezullimi punimesh, të cilat janë ndërtime pa leje, nuk janë ndëshkuar me gjobë si përcaktohet në nenin 81 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet, gjithashtu nuk ka ndonjë rakordim me Zyrën e Urbanistikës;
-vendimet e prishjes për 4 objekte, nuk janë shoqëruar me vendime ekzekutimi;
-në Bashkinë Krujë nga të dhënat e Sektorit të Urbanistikës, Drejtorisë së Tatim Taksave në segmentin rrugor Krastë - Krujë operojnë 24 subjekte prodhuese dhe tregtuese, konkretisht sipas llojit të aktivitetit:
-Prodhim Gëlqere 10 subjekte; - Gurore 9 subjekte; -Inerte 5 subjekte.
INU e Bashkisë Krujë nuk ka ushtruar kontrolle sipas përcaktimeve në nenin 12 të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 me ndryshime, ku përcaktohet se: "*INU-së i lind e drejta për ushtrimin e kontrolleve në mjediset (kantjere ndërtimi) ku kryen ndërtime dhe ku prodhohen materiale ndërtimi*", si dhe kërkesat e parashikuara në neni 80 të ligjit nr 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet.
-nga veprimtaria e këtyre subjekteve, në këtë zonë po ndodh vazhdimisht ndotje masive me pasojë në mjedis dhe në jetën e komunitetit si dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore;
-për sa më sipër lidhur me furrat e gëlqeres të cilat nuk janë të pajisura me leje ndërtimi, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë nuk ka përmbushur detyrën ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës pasi për këto raste nuk ka vendosur gjoba, nuk ka vendosur pezullim të punimeve, nuk ka vendosur prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, nuk ka përgatitur kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit lidhur me ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit dhe ta paraqiste atë pranë organeve përgjegjëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 4,

përgjegjësitë e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 5, detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 12 pargrafi i parë, ushtrimi i kontrollit;
-nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik për 21 lejet e ndërtimit, 10 prej subjekteve ndërtues nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve si përcaktohet në nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe nga ana e INU-së nuk janë ndëshkuar me gjobë, siç përcaktohet në nenin 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 me ndryshimet;
-nga ana e Inspektoratit Ndërtimor nuk na u paraqit ndonjë informacion apo relacion mbi gjendjen e situatës ndërtimore në Bashkinë Krujë.

e. [redacted] me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, nga periudha 01.11.2010 deri 31.12.2011, pasi:
-në 8 vendime pezullimi punimesh, të cilat janë ndërtime pa leje, nuk janë ndëshkuar me gjobë si përcaktohet në nenin 81 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet, gjithashtu nuk ka ndonjë rakordim me Zyrën e Urbanistikës;
-vendimet e prishjes për 2 objekte, nuk janë shoqëruar me vendime ekzekutimi;
-në Bashkinë Krujë nga të dhënat e Sektorit të Urbanistikës, Drejtorisë së Tatim Taksave në segmentin rrugor Krastë - Krujë operojnë 24 subjekte prodhuese dhe tregtuese, konkretisht sipas llojit të aktivitetit:
-Prodhim Gëlqere 10 subjekte; -Gurore 9 subjekte; -Inerte 5 subjekte.
INU e Bashkisë Krujë nuk ka ushtruar kontrolle sipas përcaktimeve në nenin 12 të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 me ndryshime, ku përcaktohet se: "*INU-së i lind e drejta për ushtrimin e kontrolleve në mjediset (kantjere ndërtimi) ku kryen ndërtime dhe ku prodhohen materiale ndërtimi"*, si dhe kërkesat e parashikuara në neni 80 të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet.
-Përgjegjësi i INU-së [redacted] në ballafaqim deklaronte se furrat e gëlqeres nuk quheshin ndërtime dhe si të tilla nuk mund të kontrollohen që kanë apo nuk kanë leje ndërtimi, por ligji nr 8405, datë 17.9.1998 me ndryshime, në nenin 48 paragrafi i parë përcakton: "*Leja e ndërtimit kërkohet për kryerjen e punimeve si vijon*:
-*Ndërtime të reja të çdo lloji, mbi e nëntokësore, shtesa impiante të ndryshme, rrugë, karriera të materialeve të ndërtimit etj"*.
-Nga veprimtaria e këtyre subjekteve, në këtë zonë po ndodh vazhdimisht ndotje masive me pasojë në mjedis dhe në jetën e komunitetit si dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore.
-Për sa më sipër lidhur me furrat e gëlqeres të cilat nuk janë të pajisura me leje ndërtimi, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë nuk ka përmbushur detyrën ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës pasi për këto raste nuk ka vendosur gjoba, nuk ka vendosur pezullim të punimeve, nuk ka vendosur prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, nuk ka përgatitur kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit lidhur me ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit dhe ta paraqiste atë pranë organeve përgjegjëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" neni 4, përgjegjësitë e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës, neni 5, detyrat e inspektoriatit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës, neni 12 pargrafi i parë, ushtrimi i kontrollit.
-Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik për 21 lejet e ndërtimit, 10 prej subjekteve ndërtues nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve si përcaktohet në nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe nga ana e INU-së nuk janë ndëshkuar me gjobë, siç përcaktohet në nenin 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 me ndryshimet.
-Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor nuk na u paraqit ndonjë informacion apo relacion mbi gjendjen e situatës ndërtimore në Bashkinë Krujë.

f. [redacted] me detyrë ish- specialiste e Zyrës së Urbanistikës dhe aktualisht me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistike, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405,datë 17.9.1998 me ndryshimet, si më poshtë:

-Në vendimin KRRT-së nr. 1, datë 19.02.2010 ka miratuar leje ndërtimi pa shqyrtuar dhe miratuar më parë studimin urbanistik pjesor në 6 raste, dhe lejen e sheshit te ndërtimit në 5 raste, ne protokollin e mbledhjes nuk është diskutuar dhe miratuar për studimin urbanistik pjesor në 6 raste dhe lejen e sheshit të ndërtimit në 5 raste, gjithashtu rezultoi se në 7 raste në formularin nr. 2, dhe formularin nr. 4, në seksionin ku firmos përgjegjësja e urbanistikës në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së ka nënshkruar emrin dhe ka firmosur ish-specialiste e urbanistikës.

-Në vendimin e KRRT-së nr. 2, datë 3.6.2010 në 3 raste rezultoi se në formularin nr. 2, leje sheshi dhe formularin nr. 4, leje ndërtimi në seksionin ku firmos përgjegjësja e urbanistikës në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së e ka nënshkruar emrin dhe ka firmosur zj. [redacted] me funksion ish- specialiste urbanistikës në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së dhe nuk ka firmosur ish- Përgjegjësi i Urbanistikës [redacted] të cilin e ngarkon ligji si Sekretar të KRRT-së, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405 datë 17.9.1998 i ndryshuar, neni 20, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër zj. [redacted] në deklaratën e saj me shkrim të paraqitur grupit të auditimi në datë 21.6.2012 cilëson se ka firmosur në emër të përgjegjëses së urbanistikës dhe në cilësinë e sekretares së KRRT-së, me pëlqim dhe urdhër verbal nga ish- kryetari i Bashkisë Krujë z. [redacted] edhe pse në vitin 2010 ka qenë e ngarkuar me detyrën e specialistes në Zyrën e Urbanistikës.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Ymer Stafa, Sotir Kozdine, Pal Daçi, Dorino Meçe dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT